

## Lëndime pas dhunës në familje

Jeni sulmuar dhe lënduar ju nga partneri juaj ose një person tjetër i afërm?

**Ju lutemi shkoni te mjekja/mjeku juaj.  
Bëni ekzaminimet dhe trajtimin e nevojshëm.  
Shëndeti juaj është i rëndësishëm për ne!**

Lejoni që lëndimet tuaja të dokumentohen edhe nga ana e mjekut. Më pas ju do të keni prova mbi dhunën që keni pësuar. Kjo gjë është e rëndësishme tani por edhe në një moment kohor të mëvonshëm. Për shembull, nëse bëni një denoncim ose nëse doni që të divorcoheni.

- ✓ Shkoni sa më shpejt të jetë e mundur në një klinikë mjekësore ose qendër urgjence. Disa lëndime nuk mund të shihen dhe dokumentohen më, më vonë.
- ✓ Tregoni gjithçka që ka ndodhur. Tregoni të gjitha lëndimet. Njoftoni me patjetër, nëse ju kanë kapur në fyt ose jeni lënduar në qafë. Na bëni me dije dhimbjet.
- ✓ Disa lëndime shihen vetëm më vonë. Moskeni turp, që ti drejtoheni përsëri një klinike mjekësore ose ambulancës së mbrojtjes kundër dhunës (Gewaltschutzambulanz) të Charité.
- ✓ Për dokumentimin duhet të përdoret një formular special. Çdo lëndim vizatohet në një fotografi të trupit dhe përshkruhet. Do ishtemirë, që lëndimet edhe të fotografohen.

**Mjeket dhe mjekët i nënshtrohen detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit. Të gjitha informacionet mbetet në kartelën tuaj si pacient. Pa miratimin tuaj nuk lejohet të informohet askush.**

Ky informacion mbështetet nga:



ÄRZTEKAMMER  
BERLIN

Senatsverwaltung  
für Gesundheit, Pflege  
und Gleichstellung

be Berlin



## Këtu do të përfitoni ndihmë

**Urgjencat (çdo ditë 24 orë)**



<b>Bundeswehrkrankenhaus</b> Scharnhorststraße 13, Berlin-Mitte	☎ 28 41 25 10
<b>Charité Campus Benjamin Franklin</b> Klingsorstraße 96, Berlin-Steglitz	☎ 45 05 52 864
<b>Charité Campus Mitte</b> Luisenstraße 65-66, Berlin-Mitte	☎ 45 05 31 000
<b>Charité Campus Rudolf-Virchow</b> Augustenburger Platz 1, Berlin-Wedding	☎ 45 05 52 000
<b>DRK Kliniken Westend</b> Spandauer Damm 130, Berlin-Charlottenburg	☎ 30 35 40 04
<b>Ev. Waldkrankenhaus Spandau</b> Stadtrandstraße 555, Berlin-Spandau	☎ 37 02 17 40
<b>Sankt Gertrauden Krankenhaus</b> Paretzer Straße 12, Berlin-Wilmersdorf	☎ 82 72 23 50

Dokumentacioni me formularin. Kjo mundësi ofrohet falas. Kushtoni vëmendje kohës së pritjes.

### **Klinika mjekësore:**

Adresat e klinikave mjekësore, të cilat janë të trajnuara dhe ofrojnë një dokumentim mjekësor me një formular të paracaktuar, mund ti merrni pranë Hotline të BIG:

☎ **611 03 00.**

### **Ambulanca për mbrojtjen kundër dhunës (Gewaltschutzambulanz) pranë Charité:**

Në ambulancë dokumentohen lëndimet nga mjeke dhe mjekëligjorë në mënyrë që të mund të përdoren në gjykatë. Caktimi i një takimi është i domosdoshëm:

☎ **45 05 70 270.** Kjo mundësi ofrohet falas.

[https://gewaltschutzambulanz.charite.de/hilfe\\_fuer\\_betroffene/](https://gewaltschutzambulanz.charite.de/hilfe_fuer_betroffene/)

## **Informacione të tjera dhe mbështetje**

**Hotline BIG: 611 03 00 (çdo ditë nga ora 8–23)**

Hotline i BIG ju informon mbi mundësitë e konsultave dhe ndërmjetëson vende të lira në institucionet mbrojtëse.

Në rast nevoje, konsultat zhvillohen me një përkthyes. Të gjitha mundësitë janë falas dhe nëse dëshirohet edhe anonime.

**Informacione online:** [www.big-hotline.de](http://www.big-hotline.de)  
[www.signal-intervention.de](http://www.signal-intervention.de)



**S.I.G.N.A.L.e.V.**  
Intervention im  
Gesundheitsbereich  
gegen Gewalt